



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 617/22 & 628/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje prej Kimete Gashi -Kryetare, Vedat Poterqoi- Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorve ekonomik (GOE) "Mühlbauer ID Services GmbH & YMALKO ShPK" me numër protokollit 617/22 dhe ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik (GOE) "AUGENTIC GmbH & IN Groupe" me numër protokollit 628/22, kundër Njoftimit të Vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit "Furnizimi me dokumente personale të identifikimit dhe mirëmbajta e sistemeve elektronike" me numër të prokurimit 214-22-3241-111, iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 09.02.2023, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen si të bazuara Ankesa e GOE "Mühlbauer ID Services GmbH & YMALKO ShPK" e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 04.11.2022, numër protokollit 617/22, dhe Ankesa e GOE "AUGENTIC GmbH & IN Groupe" e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 07.11.2022, numër protokollit 628/22, ndërkaq Vendimi i datës 21.10.2022, i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, për anulim të aktivitetit të prokurimit "Furnizimi me dokumente personale të identifikimit dhe mirëmbajta e sistemeve elektronike" me numër të prokurimit 214-22-3241-111, Anullohet kurse aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim;
2. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të sigurimit të ankesës për ankuesit GOE "Mühlbauer ID Services GmbH & YMALKO ShPK" dhe GOE "AUGENTIC GmbH & IN Groupe".

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 20.04.2022, MPB nga cilësia e saj si AK, ka publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me

dokumente personale të identifikimit dhe mirëmbajta e sistemeve elektronike” me numër të prokurimit 214-22-3241-111

Me 21.10.2022, AK ka publikuar (në platformën elektronike (e-prokurimi) Njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, duke i njoftuar të gjithë OE pjesëmarrës me Letrat standarde për eliminim.

Me 25.10.2022, Grupi i OE “AUGENTIC GmbH & IN Groupe” dhe Grupi i OE “Mühlbauer ID Services GmbH & YMALKO ShPK” kanë parashtruar Kërkesë për rishqyrtim, të cilat janë refuzuar me Vendimin e AK të datës 28.10.2022.

Kundër Vendimit të cituar si më sipër të AK, GOE “Mühlbauer ID Services GmbH & YMALKO ShPK” ka paraqitur me 04.11.2022 Ankesë në OSHP (Protokolli Nr. 617/2022). Kurse me 07.11.2022, ka ushtruar Ankesë po ashtu edhe “AUGENTIC GmbH & IN Groupe” (Protokolli Nr. 628/22).

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi:

a) Ankesat në rastin konkret janë ushtruar brenda afatit ligjor të parashikuar me paragrafin 2, të nenit 109 të LPP dhe në pajtim me dispozitën e nenit 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji.

b) Parashtruesit e ankesës, kanë statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet kjo në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesat përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se të dy ankesat në rastin konkret i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe të njëjtat bijën nën kompetencat e OSHP, në kuptim të nenit 105, të LPP.

c) Ankuesit (me shënime si më sipër) kanë marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, në pajtim me nenin 71 (Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik) dhe të njëjtit i kanë plotësuar kushtet e parapara sipas paragrafit 1, 2, 3 të dispozitës së cituar LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertit shqyrtues dhe teknik në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që në kuptim të nenit 113 dhe 124, të Ligjit të cituar, të zbatohet shqyrtimi fillestar i dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 02.12.2022, ekspertit shqyrtues dhe teknik ka dorëzuar Raportin e ekspertizës me rekomandimet si në vijim:

- Ankesat e GOE-ve ankues të aprovohen pjesërisht të bazuara;
- Vendimi i atakuar i AK të anulohet dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër, është pranuar nga të gjitha palët (Ankuesit dhe AK). Kurse, bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Prandaj Paneli Shqyrtues në këtë rast, i është referuar dispozitës së nenit 24.1, të Rregullores së Punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Paneli shqyrtues konstatoi më tej se:

- AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 12,524,000.00 €.
- AK i ka refuzuar ofertat e ankuesve në rastin konkret, me vendimin tani të atakuar, me arsyetimin, mes tjerash, se OE nuk i plotësojnë Kërkesat Teknike dhe/apo Aftësitë profesionale, sipas Dosjes së Tenderit dhe siç kërkohet me nenin 69 të LPP.

a) Pretendimet ankimore të GOE “Mühlbauer ID Services GmbH & YMALKO ShPK”

Ankuesi GOE “Mühlbauer ID Services GmbH & YMALKO ShPK” ka atakuar Vendimin e datës 21.10.2022, për anulimin e aktivitetit të prokurimit (i përshkruar si më sipër) duke theksuar se AK ka vepruar në kundërshtim me rregullativën për prokurim publik, duke eliminuar ankuesin për çështje të cilat nuk janë kritere të përzgjedhjes sipas njoftimit për kontratë dhe në dosje të tenderit dhe duke pohuar po ashtu mes tjerash, se AK i është referuar gabimisht dispozitës ligjore për anulim të aktivitetit të prokurimit, respektivisht nenit 62 paragrafi 1.1, të LPP dhe se anulimi i këtij aktiviteti po ashtu është bërë në kundërshtim dhe me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (RREUOPP). Nga ana tjetër, duke ju referuar (shkurtimisht) arsyeve të eliminimit sipas Vendimit të atakuar të AK, theksohet se “...komisioni i vlerësimit ka konstatuar se nuk keni dorëzuar oferte teknike për pajisje”. Dhe më tej, cituar: “Nuk keni dorëzuar dëshmi të mjaftueshme siç është përshkruar në nenin 69 të LPP”. Në vijim të arsyetimit të këtij Vendimi, AK ka shpjeguar se oferta e ankuesit nuk është në pajtueshmëri me kërkesën në dosjen e tenderit, të specifikimi teknik pika 7.4 Hardueri për qendrën e procesimit, sepse nuk është dorëzuar fare oferta teknike, por janë bashkangjitur broshurat dhe katalogët nga të cilat nuk janë identifikuar kapacitetet që janë kërkuar sipas specifikacionit teknik në Aneksin 1, të Dosjes së Tenderit.

Më tej Ankuesi ka shpjeguar, cituar: “...arsyeja e eliminimit nga AK-ja është kundërthënëse, sepse fillimisht është shënuar se nuk kemi dorëzuar oferte teknike për pajisje, ndërsa me poshtë për harduerin është shënuar se janë bashkangjitur broshurat dhe katalogët nga të cilat nuk janë identifikuar kapacitetet që janë kërkuar sipas specifikacionit Teknik në Aneksin 1, të dosjes së tenderit”. Duke shpjeguar po ashtu se, cituar: “Specifikimet teknike në i kemi përmbushur në tërësi siç janë kërkuar në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. Në nenin 9 tek aneksi 1 (specifikimet teknike) janë përcaktuar kërkesat për menaxhimin e projektit, kurse në 9 .1 janë përcaktuar kërkesat për implementim si në vijim:...”

Në kontekstin e këtyre pohimeve (reciproke) Paneli vëren se në Raportin e ekspertizës janë përfshirë në mënyrë të detajuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe se të njëjtat janë analizuar me kujdesin e duhur nga eksperti shqyrtues dhe teknik, natyrisht në kontekst e përgjithshëm të legjislacionit, DTP dhe vendimit të atakuar të AK. Paneli konsideron se Raporti i cituar përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse kërkohet në kuptim të nenin 114 të LPP. Në këtë rast, lidhur me pohimet e cituara si më sipër, në ekspertizë shpjegohet se, cituar: “AK në Aneksin 1 Specifikimet teknike të Detyrueshme në pikën 7.4, për dallim nga pozicionet tjera nuk ka vendosur kolonën e ofertës ku OE do të duhej të vendoste specifikacionin teknik. Më tej në kapitullin 9. Kërkesat për menaxhimin e projektit, përkatësisht tek pika 9.1 Kërkesat për implementim, janë vendosur kërkesat:... “ (përkthuar në vijim të ekspertizës), pa nevojë që të njëjtat të përkthohen sërish në këtë rast.

Si rrjedhojë, AK nga ky kontekst objektivisht është ballafaquar me rrethanën sipas së cilës, ka theksuar, cituar: “...nuk janë identifikuar kapacitetet që janë kërkuar sipas specifikacionit teknik në Aneksin 1, të Dosjes së Tenderit” dhe/ose më tej, cituar: “...nga katalogët e dorëzuar AK nuk ka mundur ti identifikoj specifikimet teknike të cilat janë kërkuar nga Aneksi 1, i dosjes së tenderit për pjesën 7.4...” Prandaj Paneli konsideron se elementet e paqartësisë dhe të konfuzionit nuk e karakterizojnë vetëm aktin e atakuar të AK (sikurse ka pohuar ankuesi), sepse elementet e paqartësisë dhe të konfuzionit e karakterizojnë edhe tenderin e ankuesit, por jo në masën e cila nuk ka mundur të korrigjohet. Paneli e kupton qëllimin e mirë të ankuesit (për dorëzimin e katalogëve) por duket pasur parasysh faktin se në kuptim të nenit 27 të LPP, i gjithë dokumentacioni i dorëzuar konsiderohet pjesë integrale e dosjes së OE. Në kontekstin e përgjithshëm të pohimeve ankimore dhe arsyetimit të vendimit të atakuar, vëren se sipas ekspertit shqyrtues dhe teknik, sipas të cilit pretendimi ankimor në këtë rast vlerësohet se është i pabazuar. Me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike ngase shpjegimi i dhënë nga ana e ESH shpie në pretendim të bazuar kurse rekomandimi final cilësohet si i pabazuar, Paneli shqyrtues me dt. 09.02.2023 ka mbajtur seancën e mbyllur me Ekspertin Teknik i autorizuar për këtë aktivitet, i njëjti pas sqarimeve të dhëna thekson se është bërë një gabim teknik në pjesën ku ka konstatuar si të pa bazuar këtë pretendim ngase i njëjti është u bazuar.

Ankuesi ka pohuar se, me 24.10.2022 ka kërkuar qasje në dokumente dhe se zyrtaret e autoritetit kontraktues kane pasur qasje korrekte dhe bashkëpunuese. Mirëpo ankuesi adreson vërejtjen se OE konkurrent, AUGENTIC GmbH-IN Groupe i ka deklaruar sekret afarist shume dokumente, disa prej te cilave nuk mund te konsiderohen sekret afarist, prandaj autoriteti kontraktues është dashur te përgatis versionin e pastruar me qellim qe te mundësohej qasje me te plote në dokumentet e këtij operatori ekonomik duke e deklaruar dyshimin se, i njëjti OE ka edhe mangësi tjera. Mes tjerash Ankuesi GOE “Mühlbauer ID Services GmbH & YMALKO ShPK” ka pohuar po ashtu se OE konkurrent ka dështuar ti përmbahet kërkesave të dosjes së tenderit për garancinë bankare pasi që i njëjti dokument nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Eksperti Shqyrtues dhe Teknik sqaron se forma e sigurisë së tenderit është në shumën e kërkuar në FTD dhe me përmbajtje sikurse përshkruhet në Aneksin 4 të dosjes së tenderit. Rrjedhimisht

pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues nuk mori në konsideratë pohimet reciproke të palëve ankuese karshi njëra tjetrës, sepse pohimet e tyre ankimore analizoi me kompetencë në raport me vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues.

Ankuesi pohon se AK i është referuar gabimisht dispozitës ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit duke pohuar mes tjerash se, cituar: "...duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktivitet të prokurimit, rezulton se AK-ja ka anuluar pa bazë këtë aktivitet të prokurimit dhe ne kundërshtim me nenin 62 të LPP, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozite". Duke pohuar më tej se, cituar: "Gjithashtu anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim dhe me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), sepse kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast". Në raportin e Ekspertit Shqyrtues dhe Teknik theksohet se dispozita e referuar nga AK në vendimin për anulim, përkatësisht neni 62, paragrafi 1 i LPP-së nuk e përshkruan shprehimisht rrethanën e anulimit për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme. Dhe në vijim ka shpjeguar se, "Përderisa AK ka konstatuar duke u bazuar në ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve se asnjëri tender nuk është i përgjegjshëm, atëherë dispozita referuese për përfundimin e aktivitetit të prokurimit do të duhej të ishte neni 44.5, pika (ii) e RRUOPP (në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës)". Dhe në këtë kontekst sipas këtij Raporti, pretendimi ankimor në këtë pikë konsiderohet pjesërisht i bazuar.

Parashtruesi i Ankesës ka pohuar në vijim se, me vendimin e atakuar të AK janë shkelur po ashtu dispozitat ligjore si në vijim: Neni 1, 7, 10, 11 si dhe 56,59,60,69 lidhur me nenin 72 të LPP dhe dispozitat e neneve 62 dhe 44.5 të RRUOPP. Duke i analizuar shkeljet e pohuara në këtë rast në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të kësaj lënde, Paneli nuk gjeti prova për shkelje tjera, posaçërisht palët janë trajtuar në mënyrë të barabartë gjatë këtij aktiviteti dhe mund të thuhet se shkeljet e pohuara në këtë rast, janë determinuar kryesisht si rrjedhojë e pohimeve ankimore, lidhur me ofertën teknike dhe broshurat nëse të njëjtat i plotësojnë ose jo kriteret lidhur me kapacitetet që janë kërkuar sipas specifikacionit teknik në Aneksin 1, të Dosjes së Tenderit.

b) Pretendimet ankimore të GOE "AUGENTIC GmbH & IN Groupe"

Ankues (me shënime si më sipër) pohon se AK e ka vlerësuar në kundërshtim me dispozitat e LPP tenderin e dorëzuar nga GOE si ofertë të papërgjegjshme edhe përkundër faktit që në tender janë dorëzuar dëshmi për plotësimin e kërkesave të njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit. Nga ana tjetër, në vendimin e atakuar të AK theksohen Dy elemente lidhur me eliminim e ankuesit nga aktiviteti i prokurimit, sikurse thuhet, cituar: "...nuk e keni plotësuar dhe dorëzuar Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara, siç kërkuar tek Seksioni 11. Fleta e të dhënave të tenderit (FTD), në faqen 13 të Dosjes së tenderit neni 3.1 (Specifikacionet teknike të detyrueshme). Dhe, cituar: "nuk keni dorëzuar Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenin 69 të LPP, që shpjegojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat e kapacitetit teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës".

Në raport me pohimet ankimore dhe vendimin e atakuar të AK, Paneli vëren se: (a) Lënda e prokurimit përshkruhet siç vijon: *Pasaportat Elektronike Blanko, letërnjoftimet Elektronike Blanko dhe Kartat tjera (jo te personalizuar) duhet te prodhohen nga një Shtypshkronje e Sigurisë se Lartë e certifikuar me certifikate të vlefshme sipas standardit ISO 14298 dhe CËA;* (b) OE pjesëmarrës duhet të kenë staf profesional, se paku katër (4) ekspert të certifikuar; (c) Dëshmi/prove janë kërkuar: Certifikatë ISO 14298 dhe CËA; Certifikate CISSP; Certifikate CISA; Certifikate, CISM; Certifikate ITIL ose ITSM. Përfshirë biografinë/CV dhe Letër reference e cila dëshmon përvojën e kërkuar (3 vite);

Në këtë rast, pa nevojë që të përfshihen në detaje shpjegimet dhe/ose pohimet e ankuesit, Paneli mori në konsideratë kryesisht konstatimet nga Raporti i ekspertit shqyrtues dhe teknik, sipas të cilit Oferta Teknike, ku ndër të tjera në faqe 17, shënohet “ne demonstrojmë pajtueshmërinë tonë me kërkesat nga Dokumentet e Tenderit...” është paraqitur pajtueshmëria me specifikacionet teknike për të gjitha pozicionet dhe rrjedhimisht dokumenti i dorëzuar përmbush kërkesën e dosjes së tenderit. Më tej, sa i përket pohimeve reciproke të palëve (OE dhe AK) lidhur me certifikatat dhe/ose validitetin e tyre, Paneli mori po ashtu në konsideratë gjetjet dhe/ose konstatimet e ekspertit shqyrtues dhe teknik, sipas të cilit “*përderisa AK ka definuar standardin e kërkuar ISO, për CËA kërkesa është e përgjithësuar dhe e pa precizuar në lidhje me standardin konkret*”.

Dhe, pa nevojë që pohimet ankimore në këtë rast të përfshihen dhe/ose përshkruhen në mënyrë specifike, Paneli veçoi faktin si në vijim: Ekspertët me datë 25.11.2022 kanë kërkuar nga Intergraf¹ i cili në dyja rastet ka ofruar shpjegime sipas së cilave, mes tjerash mund të kuptohet, cituar: “ISO 14298 është një certifikim për printerët e sigurisë (prodhuesit e dokumenteve të identitetit dhe produkteve të tjera të printuara të sigurisë duke përfshirë hologramet). CËA 15374 është për furnizuesit e printerëve të sigurisë (prodhuesit e komponentëve, të tilla si letra, bojëra, folie pa elemente sigurie etj., dhe makineri ose softuer). Ato janë të ndryshme pasi synojnë pjesë të ndryshme të zinxhirit të furnizimit. Sidoqoftë, në fushën e prodhimit të hologramit ISO 14298 përfshin të gjitha dhe më shumë se sa CËA 15374”. Dhe më tej Intergraf, ka ofruar po ashtu shpjegimet:, cituar: “...Mund të konfirmojmë se ISO 14298 i paraqitur nga IN Groupe (përfshirë nënkompaninë e saj Surys) mbulon sistemin e menaxhimit të sigurisë përfurnizuesit në industrinë e printimit të sigurisë (CËA 15374). Për këtë arsye, Eksperti Shqyrtues dhe Teknik ka theksuar se, cituar: “AK nuk ka definuar standardin për CËA në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, duke lënë kështu paqartësi dhe dykuptimësi. Sqarimi i dhënë nga AK me date 30.05.2023, nuk e precizon se për këtë kërkesë bëhet fjalë për standardin 15374”. Prandaj sipas ekspertit, pohimi ankimor nga ky aspekt është i bazur, kurse në kontekstin e fakteve dhe rrethanave të shpjeguara shkurtimisht si më sipër, po ashtu edhe Paneli Shqyrtues mbështet këtë konstatim.

¹ Shih: Ekspertizën për informata shtesë

Paneli më tej konstaton se, duke ju referuar kriterit, respektivisht kërkesave lidhur me kapacitetin teknik/profesional, AK ka kërkuar informacione shtesë nga ankuesi (me 07.10.2022) sikurse parashihet me nenin 59 dhe 72 të LPP duke theksuar, cituar: “Eksperti i certifikuar (S... Sch...)² mund të pranohet vetëm për një të certifikate, andaj duhet të dorëzohet një certifikate shtesë për një ekspert të certifikuar me Certifikate CISA ose CISM”. Ankuesi, me 11.10.2022 ka dorëzuar certifikatën CISA dhe CV për ekspertin tjetër (V... J...)³ mirëpo AK ka theksuar se biografia e të njëjtit nuk mund të pranohet, sepse sipas nenit 72 të LPP dëshmitë duhet të jenë me date para skadimit të afatit për dorëzimit e tenderëve.

Lidhur me të lartcekurat, Eksperti Shqyrtues dhe Teknik i është referuar drejtë paragrafit 3 të nenit 72 të LPP, sipas të cilit "Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit, do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet mënyrë objektive". Duke shpjeguar po ashtu se, AK ka mund të kërkojë dëshmi tjera sikurse mund të jetë kontrata e punës apo cfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar me kusht që dokumenti të pasqyrojë qartë gjendjen para datës së dorëzimit të tenderit. Dhe se, AK ka kërkuar nga GOE tjetër katër sqarime shtesë dhe në kuptimin e nenit 7, me qëllim të trajtimit të barabartë, AK do të duhej të jepte mundësinë Ankuesit në këtë rast që ta plotësojë dhe/ose sqarojë informacionin e prezantuar lidhur me stafin. Andaj, sipas sqarimit të mësipërm pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar me ç’rast një konstatim të tillë e mbështet edhe Paneli Shqyrtues.

Mes tjerash Ankuesi ka pohuar po ashtu se OE konkurrent nuk është i përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit për faktin se, i njëjti ka ofruar ekspertë që janë në marrëdhënie pune në institucione publike në Republikën e Kosovës (Bankën Qendrore të Kosovës) dhe që nuk mund të angazhohen në implementim të projektit. Dhe se AK, nuk e ka adresuar çështjen me të rëndësishme të këtij projekti, që është siguria e informatave, marrë parasysh se OE Muhibauer, një pjese të të operacioneve dhe stafit i kanë në Banjallukë, në Bosnje & Hercegovine (Republika Srpska) dhe në Stara Pazova, në Serbi. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues (ngjashëm sikurse edhe për pretendimin ankimor të OE konkurrues), nuk i analizoi pohimet reciproke të palëve ankuese karshi njëra tjetrës, sepse pohimet e tyre ankimore analizoi me kompetencë në raport me vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues si dhe në raport me synimet dhe qëllimin e këtij aktiviteti.

Në vijim të pretendimeve ankimore, Paneli konsideroi se nuk është e domosdoshme që në këtë rast të analizohen pohime tjera ankimore sepse shkeljet e supozuara të dispozitave të cituara janë determinuar nga konteksti ankimor, apriori për shkaqet dhe arsyet e shpjeguara si më sipër.

² Emri i ekspertit në shkresat e lëndës

³ Si më sipër

- Përfundim -

Për shkak të natyrës në dukje komplekse të këtij aktiviteti të prokurimit dhe nisur nga kompetencat e tija në kuptim të nenit 99 lidhur me nenin 104 dhe 105, Paneli shqyrtues ka analizuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore, përfshirë të gjitha veprimet, aktet dhe korrespondencën mes palëve dhe nga ky kontekst mund të kuptohet se elementet qenësore të pretendimeve me karakter kontestues, i referohen apriori kritereve të përzgjedhjes dhe specifikimeve teknike, respektivisht “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2)” lidhur me “Aneksi 1- Specifikimet teknike të detyrueshme” të DT. Mirëpo secili AK ka të drejtë të ushtroj autonominë e tij funksionale lidhur me parashikimin e një minimumi të domosdoshëm të kërkesave për aftësitë teknike dhe/ose profesionale për operatorët ekonomik. Dhe e njëjta përmban zgjidhjet parimore, të cilat implementohen me kreativitetin profesional të secilit AK, për secilin aktivitet të veçantë prokurimit, duke e harmonizuar kriteret e përzgjedhjes në mënyrë proporcionale dhe të ndërlidhura me natyrën e tij.

OSHP gjithnjë niset nga fakti juridik, se secili AK në cilindo nivel (lokal dhe/ose qendror) ushtron pavarësinë institucionale, mes tjerash dhe në fushë e prokurimit publik, përfshirë sidomos planifikimet e nevojave në raport me kapacitetet buxhetore. Mirëpo, vendimet e atakuara të AK në këtë rast, karakterizohen me meta formale dhe nuk i përshkruajnë elementet qenësore të aktit administrativ sikurse kërkohen në kuptim të nenit 46,47, 48 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative lidhur me nenin 115 të LPP, përderisa i njëjti përmban arsyetim brenda arsyetimit dhe konkluzione, duke i atribuar (në fund të aktit) në cilësinë e vendosje meritore. Në kuptim të legjislacionit pozitiv, konkluzionet janë akte dhe/ose instrumente juridike për drejtimin e një procesi administrativ kurse vendimi, si në këtë rast konsiston në dispozitivin e vendimit. Po ashtu akti i atakuar, vërtetë përmban në një masë të konsiderueshme përshkrime të dispozitave ligjore, përshkrimi i të cilave nuk përben arsyetim, por faktet, provat mbi vërtetimin e tyre duke ju referuar dispozitave relevante. OSHP nuk komenton përmbajtjen materiale të vendimit të AK por të metat e tilla të aktit, reflektohen në dilema dhe paqartësi tek operatorët ekonomik. Megjithatë, Vendimi i atakuar në rastin konkret, shpreh në mënyrë jo kontestuese vullnetin formal të AK, i cili në aspektet e atakimit bije nën juridiksionin e OSHP nga pikëpamja instancionale, sikurse parashihet me LPP.

Nga pikëpamja e këtij Paneli, raporti i ekspertizës përfshinë të gjitha pretendimet ankimore të palëve, sikurse kërkohet shprehimisht me nenin 114 të LPP në kontekstin e përgjithshëm të vlerësimit të pavarur të secilit pretendim, në raport me natyrën e pretendimit dhe të shkeljeve të pohuara si dhe duke e pasur parasysh qëllimin, përmbajtjen dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit. Prandaj Paneli konsideroi se rekomandimet e dhëna në të dhe në seancën e mbajtur me 09.02.23, ku Eksperti shqyrtues ka sqaruar cituar: *se mbetet në tërësi pranë Raportit të tij të dorëzuar me dt 02.12.2022 mirëpo një saktësim dua ta bëjë tek shqyrtimi pretendimeve ankimore lidhur me (GOE) “Mühlbauer ID Services GmbH & YMALKO ShPK” me numër protokollit 617/22 pretendimin që lidhet me piken 7,4 të DT,(pika 1,a) përgjigja lidhur me të është në ekspertizë si e pabazuar, ndërsa i gjithë sqarimi i dhënë nga ana ime është se pretendimi*

është i bazuar, andaj përfundimisht konfirmojë që sipas sqarimit të dhënë për këtë pikë është i bazuar ky pretendim. Kurse pretendimet tjera të këtij OE I cilësoj si të pabazuara.

Kurse sa i përket pretendimeve të (GOE) "AUGENTIC GmbH & IN Groupe" me numër protokollit 628/22 mbështetësi pranë përgjigjeve në ekspertizë, mendoj se i njëjti është i përgjegjshëm mirëpo, AK të kërkoj sqarime shtesë në lidhje me pikën për stafin e propozuar, me kriterin 8 të DT (certifikatën CISA) .

PSH konsideron se ekspertiza dhe sqarimet e dhëna për PSH nga ana e Eksperteve janë në harmoni me pretendimet ankimore, provat dhe bazën juridike dhe prandaj i mbështet dhe konsideron se rekomandimet e dhëna krijojnë efektin e duhur në procesin e rivlerësimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk e atakojnë fushëveprimin e AK (Ministritë së Punëve të Brendshme) dhe plotësimin e nevojave publike të cilat domosdo duhen përmbushur me produktet dhe/ose shërbimet e kërkuara, të cilat janë planifikuar në harmoni me nenin 8 lidhur me nenin 9 të LPP. Sidoqoftë, Paneli konsideron se AK, në pajtim me kapacitetin e tij sovran, e ka drejtuar aktivitetin e prokurimit, në të gjitha stadet e procedurës, në harmoni me nenin 10 (Mjetet për promovimin e Transparencës), nenin 11 (Informatat Sekrete Afariste), nenin 43 (Forma dhe Përmbajtja e Njoftimeve) mes tjerash, lidhur me nenin 53 (Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit). Aq më tepër, sipas neni 59 të LPP, autoritetit kontraktues i bje barra e përgjegjësisë që të themeloi një komision vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave dhe se, cituar "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës..."

Në kontekstin e përgjithshëm të këtij aktiviteti të prokurimit dhe tenderëve të dorëzuar, Paneli konsideron se rivlerësimi i këtij aktiviteti të prokurimit është determinuar nga faktet dhe rrethanat e cituara si më sipër dhe AK të veproj në përputhje të plotë me nenet 59, 60 dhe 72 dhe sidomos AK që ta ketë domosdo parasysh nenin 1 të LPP sipas të cilit, qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Vendimi sikurse në pikën 2, të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit

Prandaj bazuar në të lartcekurat dhe pas administrimit të gjithmbarshëm të shkresave të kësaj lënde Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamentit për çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK- MPB
- OE-ve ankues
- Arkivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb- faqe